



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA



MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA

Për:	Menaxherët Regjional
Nga:	Sakip Imeri, zv/Drejtor – Departamenti i Përbushjes
Përmes:	Januz Krasniqi, Drejtor i ATK-se
Data:	02.10.2007
Lënda:	Shpjegime Publike



Bazuar ne Ligjin 2004/48 neni 9, Drejtori i ATK-se mund te nxjerrë shpjegime publike për te sqaruar se si ATK do te interpretoj dhe zbatoj dispozitat e legjislacionit qe administrojn me qellim qe t'u siguroj udhëzime personave qe kërkohet te paguajnë tatimin ose t'u mbahet tatimi ne burim .

Qëllimi i këtij shpjegimi është të bëhet unifikimi i veprimeve për problemet e paraqitura gjatë zbatimin të legjislacionit tatimor.

Vendimet shpjeguese publike do t'u bëhen të njohura publikut dhe do t'u bëhen të ditura personave që preken nga ato vendime shpjeguese .

Me poshtë paraqesim disa nga kërkesat e tatimpaguesve për shpjegime publike për problemet si vijon :

1. *Prishja e mallit – për shkak te kalimit te afatit te përdorimit, thyerjes apo avarive të tjerë,*
2. *Djegia e mallit,*
3. *Shpenzimet e prezantuara nga tatimpaguesit, të bëra jashtë Kosovës,*
4. *Shpenzimet e Garancionit,*
5. *Dokumentet e lëshuara nga subjektet fiktive,*
6. *Regjistrimet për mallin ne stogë.*

Sa i përket Shpenzimeve të zbritshme për pikat e lartcekura, për periudhat tatimore të Tatimit në Fitim 2002, 2003 dhe 2004 duhet bazuar në Nenin 6 të Rregullores Nr. 2002/3 mbi “Tatimin në Fitim në Kosove “ si dhe neni 2 te Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2002 te datës 1 Prill 2002 mbi zbatimin e Tatimit në Fitim në Kosovë.

Nga periudha tatimore 2005 e tutje për TAK duhet bazuar në Nenin 7 të Rregullores Nr. 2004/51 mbi “Tatimin në të Ardhurat e Korporatave” dhe Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2005 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Për TAP, për njohjen e shpenzimeve duhet bazuar ne nenin 9 të Rregullores 2004/52 mbi Tatimin ne te Ardhura Personale dhe neni 12 i Udhëzimit Nr 02/2005 te kësaj Rregulloreje.

1. *Prishja e mallit - për shkak te kalimit te afatit te përdorimit, thyerjes apo avarive të tjera.*

Që prishja e mallit për shkak te skadimit te afatit te përdorimit te pranohet si shpenzim i zbritshëm për çështje tatimore duhet te jetë e dokumentuar me:

- *Dokumentet e blerjes se mallit i cili është prishur,*
- *Lista e mallrave te prishura ku përshkruhen: emërtimi i mallrave te prishura, njësia matëse, sasia e mallrave te prishura, çmimi kushtues për njësi i mallrave te prishura, vlera e mallrave te prishura, data e blerjes, data e prodhimit, data e skadimit të afatit të përdorimit, etj.*
- *Dokumentet e institucioneve përkatëse që verifikojnë prishjen e mallit siç janë: raporti i institucioneve sanitare si dhe dokumente tjera përcjellëse qe verifikojnë prishjen e mallit.*

Prishja e mallit do të pranohet si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur prishja me vlerën kushtuese me të cilën është blerë malli i cili është prishur.

Nëse malli ka qenë i siguruar dhe kompania e sigurimit bënë kompensimin e mallit, atëherë shpenzim i zbritshëm do të jetë diferenca negative e pa mbuluar nga kompania e sigurimit, e nëse kompania e sigurimit do të kompensoje prishjen e mallit me një vlerë më të lartë se që është çmimi kushtues i mallit të prishur atëherë diferenca pozitive do të njihet e hyrë (e ardhur) e tatueshme.

2. *Djegia e mallit*

Në rastin e djegies së mallit çmimi kushtues i mallit të djegur do të njihet si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore.

Nëse mallrat e djegura kanë qenë të siguruara dhe kompania e sigurimit bënë kompensimin e tyre, pjesa e kompensuar do të njihet si e hyrë nga kompania.

Për të dëshmuar se malli është djegur, tatimpaguesi duhet të prezantoj dokumentacionet si më poshtë:

- *Dokumentin e blerjes së mallit,*
- *Procesin nga organet kompetente se malli është djegur,*
- *Specifikacion përkatës për sasi të mallit të djegur,*
- *Dëshmi të tjera të mundshme që dokumentojnë djegien e mallit.*

3. Shpenzimet e prezantuara nga tatimpaguesit, të bëra jashtë Kosovës

Qe një shpenzim i bere jashtë Kosovës te jete i pranueshëm si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore duhet te jete :

- I dokumentuar në tërësi me dokumentacion përkatës siç janë: Kontratat, faturat, kuponët, dokumentet e pagesës, biletat e udhëtimit, urdhër udhëtimet, autorizimet etj.
- I bere ekskluzivisht për veprimtarinë e tij ekonomike.
- T' i takoj periudhës tatimore të cilës i referohet.

Varësisht nga shpenzimi duhet te jete edhe dokumentacioni mbështetës përkatës p.sh për shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit te një personi te autorizuar duhet te jene: autorizimi i atij personi (punëtori), urdhri (leja) e udhëtimit, bileta e udhëtimit, faturat për shpenzimet e bëra jashtë Kosovës, dokumentet e pagesës, kuponët për shpenzimet e ushqimit si dhe dokumente tjera mbështetëse qe argumentojnë se shpenzimet e udhëtimit zyrtar janë bërë ekskluzivisht për veprimtari ekonomike.

4. Shpenzimet e Garancionit

Shpenzimet e garancionit do te njihen si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore vetëm për aq sa kane ndodhur brenda asaj periudhe tatimore.

Fillimisht po marrim një shembull të imagjinuar se si duhet të llogaritet një produkt gjatë shitjes së tij dhe për të cilin jepet garancion :

Shuma totale e shitjes se produktit është 2,000.00 € në te cilën shumë përfshihet 1,500.00 € vlere e produktit, kurse 500.00 € vlere e garancionit qe bart produkti.

E tërë shuma e produktit prej 2,000.00 € duhet të deklarohet në rubrikën Furnizimet (shitjet) e tatueshme me normën 15%.

Bizneset gjatë kryerjes së shërbimeve të garancionit, bëjnë një specifikacion për të gjitha këto shërbime të kryera dhe në specifikacion paraqiten pjesët e ndëruara, emri i përfituesit, kohëzgjatja e orëve te punës. Tatimpaguesi për të gjitha elementet e garancionit duhet të dëshmoj me elementet të ndëruara që dëshmojnë se një gjë e tillë ka ndodhë.

Nëse Bizneseve për shërbimet e kryera ne emër te garancioneve ju kompensohet nga prodhuesit, pjesa e kompensimit do të ju njihet si e hyrë.

Konsumatorët (përfituesit) nuk paguajnë asgjë ne lidhje me këto shërbime pasi që në çmimin e blerjes është përfshi edhe pjesa e garancionit.

5. Dokumentet e lëshuara nga subjektet fiktive

Dokumentet e lëshuara nga subjektet fiktive nuk do te pranohen si dokumente për te argumentuar ndonjë blerje, shpenzim apo diçka tjetër.

ATK ka te drejte qe nga cilido person te kërkoj informata për te vërtetuar besueshmërinë e dokumenteve. Raste të tilla ATK do ti bartë institucioneve tjera për zbatimin e Ligjit për verifikim dhe ndjekje të mëtutjeshme.

Nëse është konstatuar se subjekti është fiktiv, bazuar në Nenin 38 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, mund të bëjmë ri karakterizimin e faturave të lëshuara nga Subjektet Fiktive.

Me ri karakterizim kuptojmë: rivlerësimin e faturës dhe anulimin e pjesërishëm apo të tërësishëm të faturës.

6. Regjistrimet për mallin në stoqe

Mbajtja dhe krijimi i regjistrimeve është i obliguar, bazuar në nenin 12 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat. Bazuar në këtë Tatimpaguesit janë të Obliguar që të mbajnë dhe të krijojnë dokumentacione në lidhje me Prejardhjen e Mallit .

Gjatë dokumentimit të stoqeve, tatimpaguesi duhet të posedoj dokumentacionin si në vijim:

1. Dokumenti Unik Doganor (DUD) së bashku me faturën përcjellëse nga shitësi i mallit,
2. Fatura e blerjes, e lëshuar nga shitësi dhe e cila përmban të gjitha të dhënat e shitësit dhe të blerësit,
3. Librin e blerjes ku janë të regjistruara të gjitha importet dhe blerjet vendore,
4. Lista e regjistrimit të mallit, të cilën e ka bërë vetë Tatimpaguesi në fund të vitit apo në fund të ndonjë periudhe tatimore .

Sanksionet për mos respektimin e legjislacionit tatimor në lidhje me stoqet

1. Nëse Tatimpaguesi posedon DUD-in për mallin qe posedon ne stoqe dhe ky DUD është i regjistruar në Librin e Blerjes, atëherë konstatojmë se malli që ka Tatimpaguesi në Stoqe, ka prejardhje dhe është legjitim. Së bashku me DUD-in duhet të jetë edhe fatura përcjellëse që lëshohet nga shitësi jashtë Kosovës. Në rast se DUD-i nuk është regjistruar në libër të blerjes, tatimpaguesi ndëshkohet me gjobë prej 125 €, sipas nenit 46.2 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

2. Nëse Tatimpaguesi posedon Faturë të blerjes vendore për mallin që ka në stoqe, dhe kjo faturë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me legjislacion Tatimor si dhe të gjitha të dhënat për shitësin dhe blerësin, gjithashtu kjo faturë është e regjistruar në libër të blerjes, atëherë konstatojmë se malli i cili gjendet në stoqe ka prejardhje dhe është legjitim. Në rast se kjo Faturë nuk është regjistruar në libër të blerjes, tatimpaguesi ndëshkohet me gjobë prej 125 €, sipas nenit 46.2 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

3. Në rastet kur Tatimpaguesi nuk posedon dokumentacionin e kërkuar për argumentimin e stoqeve, konstatohet se malli në stoqe është pa prejardhje dhe tatimpaguesi përveç tjerash do të trajtohet sipas nenit 49.5 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.